

VENDIM
Nr. 91, datë 6.4.2021

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK, PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 35, DATË 4.2.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, nenit 92, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 40/2 prot., datë 31.3.2021, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. nr. 64, seria NPM08P.

3. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të Bordit nëpërmjet shkresës nr. 51/2 prot., datë 11.2.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Sa më sipër, brenda afatit 30-ditor, brenda të cilit shoqërisë i është dhënë e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar në ERE shkresën nr. 06/21 prot., datë 3.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 51/4 prot., datë 5.3.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 35/2021, shoqëria ka paraqitur argumentet dhe dokumentacionin shoqërues.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të për gatitin një relacion për bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i paraqesin Bordit propozimin përkatës.

- Në përmbushje të afatit 30-ditor për të për gatitur relacionin përkatës mbi argumentet e paraqitura nga shoqëria, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35/2021, me qëllim që t’i jepet mundësia asaj të depozitojë në ERE dokumentacionin vërtetues mbi sa deklarohej nga ana e saj, si dhe për sqarime të mëtejshme apo dokumente shtesë në lidhje me kërkesën e parashtruar.

- Në nenin 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet, se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Biopower Green Energy” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti